

## AUDITIMI I TË ARDHURAVE TË BUXHETIT TË SHYPTIT NË KLSH NË FRYMËN E IntoSAINT

*nga Albana AGOLLI – Drejtore Departamenti,*

*botuar në gazetën “Rilindja Demokratike”, më 11 shkurt 2015.*

Në datat 26-27 Janar 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilloi në qytetin e Vlorës Analizën Vjetore të punës së Institucionit, për vitin 2014. Analiza e veprimtarisë së KLSH dhe në nivel Departamentesh Auditimi u mbajtën në mjediset e Universitetit Publik “Ismail Qemali” në Vlorë. Ato u realizuan nën një këndvështrim të ri, në frymën e Metodologjisë IntoSAINT (Metoda e Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit Publik), mbështetur në standardet INTOSAI, ku krahas analizës së veprimtarisë së departamentit u bë vlerësimi i aspekteve dhe procedurave vunerabël si dhe përcaktimi i rekomandimeve për forcimin e integritetit. Gjithashtu zhvillimi i kësaj analize në ambientet e Universitetit Publik “Ismail Qemali” solli si risi bashkëveprimin me pedagogët dhe studentët të cilët morën pjesë aktive në zhvillim e kësaj analize pune së bashku me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe organizatave profesionale të fushës, partnerë të KLSH-së, si Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Ass. Dr. Sazan Guri, z. Gledis Gjipali, etj., si dhe analistë dhe publicistë të njohur, z. Artur Çani, z. Mitro Çela, z. Ago Nezha dhe gazetarë të qytetit të Vlorës.


Në këtë kuadër, Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, zhvilloi analizën vjetore në një sallë të veçantë, pasditen e datës 26 janar dhe paraditen e datës 27 janar. Gjatë seancës së parë, u bë një përmbledhje e veprimtarisë audituese të Departamentit, duke u përqendruar kryesisht në realizimin e programit vjetor të miratuar të auditimit, treguesit për vitin 2014 dhe zbatimi i masave të rekomanduara, të cilat janë më të lartat e arritura gjatë 5 viteve të fundit.

Në vitin 2014 janë evaduar 23 auditime nga 21 auditime të planifikuara në të cilat janë zëvendësuar 9 subjekte të administratës tatimore me subjekte të administratës doganore kjo për faktin e pengesës së njohur dhe të pakuptimtë të administratës tatimore qendrore, e cila në mosrespektim të Kushtetutës dhe ligjit për KLSH penguan KLSH për të kryer auditime të plota mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore.

Gjatë vitit 2014 departamenti ka performuar më mirë në krahasim me 5 vitet e fundit pavarësisht numrit të audituesve të departamentit i cili ka ardhur duke u ulur sipas pasqyrës së mëposhtme:

<b>PERIUDHA</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
Nr. Auditimeve	19	17	12	20	23
Gjetjet në mijë lekë	722 000	185 000	72 000	432 000	1 053 026
Nr. Audituesve	18	20	15	14	16

Pjesëmarrja mesatare në auditime për çdo auditues ka ardhur duke u rritur. Në vitin 2010, një auditues realizonte mesatarisht rreth një auditim në vit, njëkohësisht zbulonte rreth 40 milion lekë dëme. Në vitin 2011 një auditues kryente më pak se një auditim në vit dhe zbulonte 10 milionë lekë dëme. Në vitin 2012 një auditues kryente rreth 1/2 auditime në vit dhe zbulonte 10 milionë lekë dëme. Në trend rritës paraqitet viti 2013 ku një auditues kryente rreth 1 e 1/2 auditime në vit dhe zbulonte 30 milionë lekë dëme. Në vitin 2014, mesatarja për auditues është po 1 e ½ auditime në vit dhe njëkohësisht një nivel rreth 65 milionë lekë dëme të zbuluara.



Në krahasim me vitet paraardhëse gjetjet nga auditimet dhe masat e rekomanduara kanë ardhur në rritje nga pikëpamja sasiore dhe cilësore. Konkretisht:

- Dëmi ekonomik i rekomanduar 100 % për zhdëmtim (kryesisht mungesë të ardhurash) në vitin 2014 paraqitet në shumën 1,053

milione lekë nga 432 milione lekë në vitin 2013, ose 2.4 herë më i lartë krahasuar me vitin 2013 ose 14.6 herë më i lartë krahasuar me vitin 2012.

- Masat organizative të rekomanduara në vitin 2014, paraqiten gjithsej 221 masa nga 160 masa të rekomanduara në vitin 2013, ose në masën 138 % të vitit 2013.
- Masa disiplinore të rekomanduara në vitin 2014 paraqiten 157 masa nga 139 masa të rekomanduara në vitin 2013, ose 18 masa më shumë.
- Masa administrative në vitin 2014, janë rekomanduar 92 masa nga 8 në vitin 2013.
- Gjithashtu, gjatë vitit 2014 janë dërguar 2 subjekte dhe 10 persona në organin e prokurorisë.

Departamenti konstatoi se përpjekjet janë pozitive në raport me objektivin për fuqizimin dhe rritjen e cilësisë së auditimeve, por nuk ka bërë përpara në analizën e riskut. Puna e mbështetur në analizën e riskut jo vetëm premtion dhe jep rezultate në produktin që del nga auditimi, por, çfarë është më e rëndësishme, rrit efektivitetin e auditimit.

Gjatë vitit, krahas impenjimeve në auditim, është ndjekur me përparësi programi i trajnimeve të organizuar nga Sektori i Trajnimeve në KLSH. Gjithsej janë kryer 477 ditë trajnimi dhe mesatarja e departamentit është 30 ditë trajnimi në vit për çdo auditues, tregues ky në rritje krahasuar me vitin 2013 që ishte 25 ditë. Gjithashtu audituesit e departamentit kanë qenë aktiv në median e shkruar ku numërohen 14 shkrime, në konferencën e tretë

shkencore të KLSH-së me 1 kumtesë, si dhe në përgatitjen e standardit ISSAI 5220, botim i KLSH.

Gjatë vitit u kryen vlerësimet për çdo auditues, vlerësim i cili është bazuar në informacionin e nevojshëm individual vjetor të grumbulluar për çdo auditim dhe formularit për vlerësimin e punës individuale të auditimit me të cilin janë njohur të gjithë audituesit.

Në seancën e dytë, në lidhje me vetëvlerësimin e shkallës së integritetit, Departamenti përcaktoi proceset primare dhe sekondare, fushat vunerabël për çdo proces si dhe faktorët që rrisin vunerabilitetin dhe impaktin. U bë vlerësimi me pikë për rreth 40 fusha vunerabël sipas proceseve dhe rreth 50 faktorë që ndikojnë në to, të cilat u pasqyruan në pyetësonin i cili ju shpërnda të gjithë audituesve të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit. Mbas plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimit u realizua në grup vlerësimi me pikë për matjen e nivelit të përgjithshëm të vunerabilitetit të departamentit dhe shkallën e ndjeshmërisë si dhe u realizua matja e maturitetit të sistemit të kontrollit, monitorimit dhe mbulimit të vunerabilitetit. U evidentuan hendeqet midis vunerabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe monitorimit. Pas përpunimit të të dhënave nga rezultatet e pyetësorëve, u mblodhën mesataret e pikëve për çdo auditues dhe nga vlerësimi, niveli i përgjithshëm i vunerabilitetit si departament rezultoi mesatar më afër kufirit të ulët.

Në përfundim, çdo anëtar i departamentit plotësoi edhe një pyetësor vetëvlerësimi për analizën e veprimtarisë vjetore, pyetjet e të cilit kishin

lidhje me njohjen e subjektit të auditimit, planifikimin vjetor, programet, kryerjen, raportimin dhe kontrollin e cilësisë së auditimeve të realizuara.

Nga analiza u formuluan dhe rekomandimet për departamentin për vitin 2015, si: gjetja e rrugëve për të argumentuar dobishmërinë e studimit të literaturës dhe jo thjesht të leximit të saj; përmirësimi i mënyrës së punës dhe veprimtarisë me theks vendosjen e prioriteteve dhe proceseve të punës primare në radhë të parë dhe ato sekondare; krijimi i një regjistri në departament për regjistrimin e rasteve të shkeljes së etikës dhe vendosja e një objektivi për promovimin e modeleve shembullore në sjellje dhe veprimtari në departament, duke u udhëhequr nga parimi “të udhëheqësh me shembullin personal”.

Prezenca aktive e përfaqësuesve të shoqërisë civile, analistëve, pedagogëve dhe studentëve dhe pavarësia e plotë e mendimit të tyre i dha një frymë të re zhvillimit të analizës së veprimtarisë së Departamentit ku përveç arritjeve u evidentuan edhe dobësitë me qëllim përmirësimin e tyre në të ardhmen.